

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Tuba dhe Rakorderi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): tuba kanalizimesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 157,469,886 (njqind e pesedhjetë e shtatë milion e katerqind e gjashtedhjetë e nente mijë e teteqind e tetedhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1.597.543,74 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e tre presje shtatëdhjetë e katër) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 24.10.2024 është 98.57 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 3.149.398 (tre milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 31.950,875(tridhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë presje tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 24.10.2024 është 98.57 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm

vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 62,987,954.4 (gjashtedhjetë e dy milion e nentëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nentëqind e pesëdhjetë e kater presje kater) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

$$157,469.886 \times 40\% = 62,987,954.4$$

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në

ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.5.Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specififikimet teknike të mallrave që do të ofrohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht....

Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuetshmërisë së produkteve me specififikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.7. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit	

		, ëeb-siti		ose nr. Faqes ne katalog	
--	--	------------	--	--------------------------	--

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-“Emertimi i Katalogut të prodhuesit.

-Referenca në katalogje, kodi I produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr I faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut ne katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

2.8.Për të gjitha mallrat të cilat kanë kontakt me ujin e pijshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm DVGW, ose ekuivalente (të vlefshme) të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Referuar faktit se në preventivin objekt prokurimi kërkohen mallra të cilat do kenë kontakt me të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm(furnizim jetik për qytetarin) kërkohet që cilësia të jetë e lartë e standarteve të kërkuara me qëllim mosndikimin e faktorëve të jashtëm në cilësinë e ujit.

2.9.Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK, do të paraqesë çertifikatën e origjinës , raportet e testeve te fabrikes,certifikatat e cilesise dhe garancise së mallrave, origjinale ose fotokopje të noterizuar të tyre, te cilat shërbejnë per te vertetuar respektimin e specifikimeve teknike , cilësine apo garancinë , që mallrat duhet të kenë , në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.(Në zbatim te rekomandimit te APP nr 2106 date24.03.2021).

2.10. Operatori ekonomik, ne momentin e hapjes se ofertave, duhet te paraqese mostra te mallrave qe ofron, qe duhet te permbushin te gjitha specifikimet teknike.Mosdorezimi i mostrave ne

momentin e hapjes se ofertave ose mosperputhja e mallrave te ofruara me mostrap e paraqitura, eshte kusht per skualifikim. Mostrap qe duhet te paraqiten jane:

1	Tub PE 100 Pn 10 Dj-20mm
35	Staf gize D-200x2" mm
40	Tulip 150
44	Niples Xingato 2"
46	Xhunto D-20x1/2"
59	Saracineske D-1/2"
65	Saracineske D-80+fllan
76	Stafe EF D-250x50mmPE
83	Manikote EF 250 PN 20
94	Manikote EF D63 mm PE
102	Ti EF D-125 mm PE
103	Ti me ngjitje D160
107	Reduksion 75x63mm EF
111	Reduksion63x50mm PE
128	Reduksion xingato 1"x1 1/2"
129	Tapa fundore D25 PE
138	Staf PE D-90x3/4"
148	Brryl EF D-200 mm PE
168	Fllanxhe celiku D-50 Pn 16
172	Fllanxhe Adaptor d-90
183	Adaptor PE d-90 mm
193	Kundralvalvul 2"
196	Manikote xing 2"
197	Tap xing 2"
206	Fashete inoksi (riparuese)240-260mm
213	Fasheta riparimi inoksiDN (190-210) X Fllanxhe DN100
218	Bashkuese PE 25x25
238	Gomina guarnicioni D 100
257	Bulona 18x90
280	Brryl xhunto M 20x1/2"
281	Pe lini
283	Brryl me kompresion 25x25
326	Filter uji 3/4"
332	Xhunto Cmontimi 400
351	Tub brinjezuar SN8Dj-200mm
361	Kundralvalvul D-100 Pn 16
390	Stafe EF D-160mmPEx63 mm PE me shpim ne prani te ujit
434	Saracineske Flutur Horizontale Dn-400 PN25
436	Tub PPR 20 mm (PN20)
442	Manikota PPR 20 mm

449	Tape PPR 32 MM
453	Adaptor M ppr 20x1/2"
467	Ajrues me 3 funksione DN50 Pn 16
470	Bashkues Gize me Thumba 87 / 117
484	Nipples plastike M PP DN 1/2"
490	Saracineska plastike me kompresion 20
496	Saracineska plastike 1 1/4" F F
553	Adaptor Transit 20-1/2" M
599	Berrylla Gize me fllanxa DN50
608	Shtanga per saraqineska gize DN300-400

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Njësia e Prokurimit gjykon se qëllimi i vendosur për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Theksojmë se mostrat për produktet e kërkuara më lart nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i tyre është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Profilaktika e rrjetit të ujit është shumë e gjere, ne baze te zonave te ndryshme dhe lartesisive te depove percaktohen presionet nen te cilat do te punojne te gjitha pajisjet dhe materialet hidraulike. Presione te rrjetit hidrik te UKT variojne nga 10 atm deri ne 40 atm prandaj edhe materialet qe do te perdorim duhet te jene perkatesisht te pershtatshme me presionin nen te cilin do te punojne.

Per sa i perket cilesise se rakorderive, saracineskave,kundravalvulave dhe materialeve te tjera te perdorura ne rrjetin hidrik, te gjitha duhet te jene te nje cilesie te larte per te siguruar jetegjatesi ne pune dhe lehtesi ne kryerjen e manovrave (shpesh here nevojitet te behen manovra emergjence, ndaj nuk mund te lejohen vonesa ne manovra per shkak te keqfunksionimit te ketyre artikujve, gje qe do te conte ne difekte apo rrezikshmeri te larte ne pune).

Temperatura ne te cilat materialet duhet te punojne duhet te jene kryesisht nga – 20 °C deri ne +45 °C bazuar ne statistikat metereologjike te vendit tone.

Standartet e kerkuara ne specifikime teknike jane bere duke u bazuar tek Vkm nr.83 e vitit 10/2/2021 si dhe tek standartet Europiane ne fuqi.

Per sa i perket spesorve te kerkuar ne specifikimet e tubave, jane kerkuar ne baze te presionit atmosferik qe duhet ti rezistojne.

Materiale kerkohen cilesore sepse shumica e tyre do te montohen nen toke dhe ne rast avarie kosto e riparimit eshte shume e larte sepse nuk perfshihen vetem materiale e demtuar e ukt por dhe infrastruktura e qytetit.

Tubot polietileni kerkohet me cilesi te larte sepse perdoren per uje te pijshem dhe duhet te jene rezistent per te mos patur avari per periudhe te gjate kohe.

Tubot pvc perdoret per rrjetin e kanalizimeve dhe kerkohet cilesore ne menyre qe te shmangen avarit ne rrjetin e kanalizimeve

Tubot e celikut duhet te jene me spesoret e percaktuar per shkak se duhet te rezistojne presionit atmosferik te rrjetit.

Rakorderite EF duhet te jene per tensionin ngjites 40 v dhe konektoret duhet te kene diameter 2-4 mm ne menyre qe te pershtaten me rrjetin hidrik.

Reduktoret PE duhet te pershtaten me rrjetin e tubacionit te ujesjellesit.

Stafa PE duhet te jete me cilesi te larte dhe te kete impakt te larte ne parandalimin e rrjedhjeve te mundshme qe mund te shkaktohen nga diferenca e diametrit te tubacioneve

Stafa EF me shpim ne prani te ujit tensioni i ngjitjes të jetë 40V dhe konektoret duhet të jenë me diameter 2-4mm per tu pershtatur me rrjetin e ujesjellesit

Staf gize me fllanxhe duhet te jene te ngjashme si fashetat e gizes per nga funksioni por ndryshon nga konstruksioni dhe nga pershtatshmeria ne tubin ku do te instalohet.

Fashetat Riparim Inoksi jane kerkuar te jene fleksibel dhe te kene disa shtresa inoksi te veshura me gome EPDM rezistente ne temperature -20 deri +120°C dhe jene te prodhura e te pershtatshme posacerisht per linjat e furnizimit te ujit te pijshem ne menyre qe pas montimit te mos nderveprojne me ujin dhe te leshojne kimikate te cilat kontaminojne rrjetin.

Adaptor duhe te jete materiali polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C.Koka e filetimit kerkohet konike ne menyre qe te shmangen rrjedhjet e mundshme nga diferencat qe mund te krijohen ne tubacion. Dhe te jete material antikorroziv dhe perberja e materialit te jete kunder ngjitjes se algave dhe baktereve.

Fllanxha Adaptor kerkohet prej material celiku me veshje plastike per te bere te mundur pershtatshmerine me rrjetin hidrik.

Fllanxhat e Saldimit duhet te jene te perbera prej materiali celik dhe te jene saldueshme ne menyre qe te pershtaten me rrjetin ku do te saldohen.

Fllanxha Spar perdoret ne aplikimet e tubacioneve te cilat jane te perbera prej materialesh HDPE, PE,PVC.

Fllanxha Rregjister duhet te jete me dalje fllanxhe dhe me qafe te tipit femer per te bere te mundur atashimin apo instalimin ne tub.

Xhuntoja e Zmontimit per nga nga funksioni eshte i njejte me Fllanxhen Regjister diferenca e vetme eshte ne qafa e filetuar.

Tapa me material PE , limiti i forces se keputjes te se ciles per 1mm² te jete jo me pak se 23N dhe te gjeje perdorimi ne tubot e ujit.

Bashkues PP materiali eshte kerkuar polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, dhe faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jete i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit.

Bashkues Gize me gomine PN10-PN16 bashkuesi me gomine duhet te jete i perbere prej materiali gize ndersa dadot dhe bulonat e rondelet duhet te jene te perbera prej materiali celik inoks. Funksioni I bashkuesit eshte te atashoj dy tubacione ku presioni normal eshte 10- 16 bar.

Brryla PN10 Materiali te jete prej polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C

Brrylat duhet te jene te perbera prej materiali PE dhe te jene te pershtatshem per linjat e ujesjellesave.

Saracineska me celes magnetik ka per funksion te bllokoje rrjedhjen e ujit ne linjen e tubacioneve te abonenteve ne rast se ata nuk paguajn detyrimet qe kane ndaj Ujesjelles –Kanalizime Tirane.Produkti duhet te jete e perbere nga saracineska dhe nga kapuci magnetik. Mekanizimi I cili kryen funksion e hapjen apo mbylljen e saracineskes duhet te jete i inkorporuar ndermjet aksit te saracineskes dhe kapucit magnetik.

Saracineska duhe te jete tipit me top dhe pajisur me leve per funksionimin e saj . Trupi I saracineskes duhet te jepe i perbere prej bronzi dhe rezistente ndaj temperaturave te jashteme nga -20°C deri ne + 45°C si edhe ndaj presioneve te larta deri ne 16 bar.

Saracineskat duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila ben te mundur rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione.

Saracineskat G pn 25-40 duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione.

Saracineskat G me Fllanxhe Ø300-Ø700 PN 16 duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione.

Ajrues celiku produkti duhet te jete i perbere prej material gize dhe i paisur me fllanxhe per tu pershtatur me rrjetin hidrik.

Rakorderite zingato duhet te perbehen nga material metalik xingato . Presioni qe duhet te durojne te jete 16 bar ne temperaturen nga -20°C deri ne 63 °C.

Manometrat perdoren per matjen e presionit ne linjat e ujesjellsave.

Kasetat metalike duhet te jene te konstruara me material llamarine dhe te kene te 1 dere, dhe te kete hapsire te mjaftueshme per te instaluar brenda matesin e ujit ½

Dado dhe bulona sipas përmasave në preventiv. Të jenë material celik i temperuar.

Valvolat e moskthimit kane per funksion mos lejimin e rrjedhjes se ujit ne rast se mungon presioni i nevojshem.

Guarnicionet duhet te jete te pershtatshme te perdoren per tubat e ujesjelles kanalizime.

Depozita me materjal rezine rezistente ndaj kimikateve dhe agjentëve atmosferikë, të kenë teknologjinë e mos lejimit të krijimit të algave per kontaminimin e ujit.